



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 19367 Prot

Shkodër, më 20.12.2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e liqenit të Shkodrës, bashkia Shkodër".

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,


Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e liqenit të Shkodrës, bashkia Shkodër".

Duke Ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHqipërisë
BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2023

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ datë ____ / ____ / 2023

“PËR

**MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA
NË TERRITORIN E LIQENTIT TË SHKODRËS, BASHKIA SHKODËR”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës _____, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin” të ndryshuar; ligjit nr.8743, date 22.02.2001 “Për pronat e paluajshme të shtetit”, të ndryshuar; VKM nr.171, date 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar; VKM nr.321, datë 28.05.2014 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendëshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, të ndryshuar si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e bashkisë Shkodër;


VENDOSI:

1. Të miratoj hartën përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e liqentit të Shkodrës, Bashkia Shkodër”, sipas materialit hartografik bashkëngjitur
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Beqet BFCI



Zv. Kryetari



Drejoria Turizmit




Drejoria Studimeve, planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve

Idjalont Shasa



Drejoria Juridike





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA SHKODËR

RELACION

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA NË TERRITORIN E LIQENIT TË SHKODRËS, BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar, ligjit nr. 93/2015, “Për Turizmin” të ndryshuar ; ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, ligjit nr. 9251, datë 08.07.2004, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar,

Në kuadër të mbarevajtjes së sezoni turistik si dhe në bazë të një kërkesë të paraqitur nga një subjekt për vendosjen e lojërave ujore që fryhen dhe qëndrojnë mbi ujë, të standarteve bashkëkohore dhe shumë të sigurta, synohet të kthehet zona e Shirokës në një vend takimi të gëzueshëm për familjet, në një vend më mikpritës për fëmijët, duke e kthyer këtë zonë në një destinacion më tërheqës për turistët dhe vendasit, si dhe duke ndikuar në forcimin e ekonomisë lokale. Për këtë arsye është menduar të përfshihet edhe zona e Shirokës brenda zonës së plazheve të lejuara.

Në zbatim të VKM nr. 171 dt. 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar, po ju paraqesim për miratim hartën e përgjithshme për dy plazhet e lejuara të zonës së Shirokës, të cilat për vitin 2024 kemi menduar që të jenë plazhe publike, dhe sipas kërkesave, vitet në vazhdim, do parashikojmë që të jenë edhe të menaxhueshme. Në hartën bashkëlidhur janë të pasqyruara kriteret të cilat përfshihen në pikën 1 të nenit 4 të VKM 171/2019, si më poshtë:

- a) hapësirat e plazhi publik;
- b) hapësirën ujore të lejuar për notim (zonë e rrethuar me bova);
- c) vendbazim për lojra ujore.

KRYETAR


Bengë Beci





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

HARTA E PËRGJITHSHME PËR PLAZHET E LEJUARA
PLAZHI SHIROKE - ZOGAJ



Legjenda

- Zona e sigurte per notim
- Plazh Publik
- Lojra Ujore